

MONITOR

E PERJAVSHME VITI i VI i BOTIMIT NR. 17 (273) - 2 MAJ 2007 Çmimi 300 lekë, 3 EURO

BIZNES - EKONOMI - TREG

neni 42 - paga minimale
Biznesi qeverisë: Mos u nxitoni

FAQE 34

turizëm
Çmimet në Shqipëri, më të lartat

FAQE 38


biznes
Qindarkat që sollën miliona

FAQE 27

KUJDES NGA PUNONJËSIT?!

Nëse ata shfrytëzojnë vendin e punës për të kryer një veprim të jashtëligjshëm, punëdhënësi rrezikon deri në **800 mijë euro gjobë.**

Flasin juristët: Ja interpretimi i projekt-ligjit më të ri për procedimet penale të personave fizikë



është person fizik dhe ndryshe kur ai është person juridik.

Për personat fizikë Kodi Penal parashikon si ndëshkim burgimin ose gjobën, në vartësi të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer.

Personi juridik, autor të veprës penale, nuk mund "ta futësh në burg".

Neni 8, ndaj personave juridikë, që kanë përgjegjësi për kryerjen e veprës penale, parashikon dy lloje dënimesh: dënime kryesore dhe dënime plotësuese.

Si dënime kryesore janë: gjoja dhe mbarimi i personit juridik (neni 9), ndërsa si dënime plotësuese (neni 10) janë: mbyllja e një ose më shumë veprimtarive a strukturave të personit juridik; vendosja e personit juridik në administrim të kontrolluar; ndalimi për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit të fondeve publike; heqja e së drejtës së marrjes ose përdorimit të licencave, autorizimeve, koncesioneve ose subvencioneve; ndalimi për të kërkuar publikisht fonde dhe burime financiare; heqja e së drejtës së ushtrimit të një a më shumë veprimtarive ose operacioneve; detyrimi për publikimin e vendimit gjyqësor.

TË NDËSHKOSH NJË PERSON JURIDIK

Gjoja konsiston në pagimin, në favor të shtetit, të një shumë të hollash, që dalin nga pasuria e personit juridik të dënuar (neni 11), për krimet, që sipas Kodit Penal, parashikohet një dënim, minimumi, jo më pak se 15 vjet burgim ose burgim të përjetshëm, personi juridik dënohet me gjobë nga 15 deri në 100 milion lekë.

Për krimet, që sipas Kodit Penal, parashikohet një dënim, minimumi, nga 7 deri në 15 vjet burg, personi juridik dënohet me gjobë nga 10 deri në 15 milion lekë.

Për krime, që sipas Kodit Penal, parashikohet dënim, minimumi, më pak se 7 vjet, personi juridik dënohet me gjobë nga 1 deri në 10 milion lekë. Për kundërvajtjet penale kjo gjobë varion nga 300 deri në 1,000 mijë lekë. Pra, siç shihet, ligjvënësi ka parashikuar masa të ashpra për të parandaluar veprimtaritë kriminale të personave juridikë, të cilat në kushtet e informalitetit të lartë shqiptar, përbëjnë rrezikshmëri të lartë shoqërore.



NDRYSHIMI

Për krimet, që sipas Kodit Penal, parashikohet një dënim, minimumi, nga 7 deri në 15 vjet burg, personi juridik dënohet me gjobë nga 10 deri në 15 milion lekë

Në nenin 12 jepen në mënyrë të detajuar rastet kur si masë ndëshkuese ndaj personit juridik, që ka kryer vepër penale është "Mbarimi i tij", pra ndërprerja e veprimtarisë dhe vënia e tij në likuidim. Kjo është ekuivalenti i dënimit me vdekje. Një masë e tillë zbatohet ndaj atyre personave juridikë, që janë themeluar me qëllimin që të kryejnë vepra penale, apo kanë vënë në dispozicion pjesë

të veprimtarisë së tyre për kryerjen e veprave penale, apo kur nga kryerja e veprës penale kanë ardhur pasoja shumë të rënda.

Ndërsa në nenet 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19 përshkruhen dënimet plotësuese, që shoqërojnë dënimin kryesor, dhe rastet e zbatimit të tyre nga Gjykata.

Në nenet 20 dhe 21 parashikohen rrethanat lehtësuese dhe rënduese në të cilat kryhet vepra penale; rrethana, që ndikojnë gjykatën në përcaktimin e masës së dënimit, si shlyerja e dëmit të shkaktuar, eliminimi i pasojave, kryerja e përsëritur e veprës etj.

Ligjvënësi ka bërë dallimin kur autor i veprës penale është një person juridik publik ose organ i qeverisjes vendore. Në çdo rast, këta persona juridikë nuk mund të dënohen me mbarimin e tyre, por

mund t'i nënshtrohen gjobës dhe dënimeve të tjera plotësuese (nenet 9 dhe 10).

DISPOZITA PROCEDURIALE

Ndaj personit juridik, që ka përgjegjësi për kryerjen e veprës penale, për aq sa është e mundur, zbatohen dispozitat procedurale penale për personin nën hetim dhe të pandehurin (neni 25).

Personi juridik, që procedohet penalisht, përfaqësohet nga organi ose avokati i emëruar nga organi i personit juridik. Në të gjitha hallkat e hetimit paraprak dhe gjykim të çështjes zbatohen rregullat e Kodit të Procedurës Penale (neni 26). Dispozitat e titullit IX, kreu III të K.Pr.P. mbi gjendjen juridike zbatohen edhe për personat juridikë, të dënuar penalisht. ■



Nga Igli TASHI
Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomiksit,
Universiteti i Lozanës, Zvicër

Në vazhden e luftës kundër korrupsionit dhe informalitetit në ekonominë shqiptare, qeveria ka marrë kohët e fundit një nismë duke propozuar një projektligj, i cili ngarkon personat juridikë me një përgjegjësi penale. Interesante në diskutimin e një analize kosto-përfitim të zbatimit të këtij ligji në ekonominë shqiptare janë argumentet dhe motivimi, që ka pasur qeveria për të hedhur në treg një nismë të tillë. Argumentet dhe motivimi do të mundën të na japin sinjalet e para mbi cilësinë e zbatimit të ligjit, si dhe mbi cilësinë dhe ndikimin e tij në ekonominë shqiptare. Pa asnjë dyshim një nismë e tillë do të ketë një ndikim të madh në mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të ndërmarrjeve të thjeshta dhe tregtare. Ky ndikim i rëndësishëm vjen për 2 arsye:

-E para, ka të bëjë me kapacitetet e ndërmarrjeve shqiptare për të qenë konform këtij ligji dhe

-E dyta, mbi një skepticizëm pak a shumë legjitim në kapacitetin e organizmave shtetërore në zbatimin e ligjeve të një rëndësie të tillë.

Përsa i përket këtij ligji, në komunikimet publike nga ana e ideatorëve, argumenti kryesor i përdorur është domosdoshmëria për t'iu përgjigjur një kërkesë këmbëngulëse nga ana e institucioneve ndërkombëtare. Kjo lloj përvoje ekziston dhe në legjislationet perëndimore dhe fakti që një ligj i tillë ekziston na detyron edhe ne të përshtasim legjislationin tonë në këtë sens. Pra, në një mënyrë më të

TREGU, I PAMATURUAR

Një vështrim mbi përvojat e vendeve të zhvilluara për përgjegjësinë penale të personave juridikë. Sa i zbatueshëm do të jetë një ligj i tillë në kushtet aktuale të vendit tonë

përmbledhur argumenti është: të tjerët e kanë bërë dhe ne duhet ta bëjmë gjithashtu. Atëherë mënyra më e mirë për të kuptuar forcën dhe dobësitë, argumentet pro dhe kundër ligjit, është studimi i përvojës së legjislacioneve të cilat e kanë zbatuar prej shumë kohësh konceptin e përgjegjësisë penale të ndërmarrjeve.

Para çdo lloj argumenti duhet të theksojmë faktin që përgjegjësia penale për personat juridikë është një koncept që ekziston, por kjo nuk është pjesa më e rëndësishme e problemit. Diskutimet e shumta të specialistëve, përsa i përket këtij koncepti, qëndrojnë më shumë në ashpërsinë e zbatimit të ligjit dhe mbi të gjitha, mbi faktin se cili nga subjektet juridikë (personi fizik, apo juridik) do të jetë objektivi i parë i ligjit. Këtu kemi ndryshime të mëdha ndërmjet konceptimeve jo vetëm të legjislacioneve në të dyja krahët e Atlantikut, por dhe ndërmjet legjislacioneve në gjirin e demokracive europiane.

SHBA, MB ZBATUAN TË PARAT KËTË LIGJ

Gjeneza e konceptimit dhe e zbatimit të një ligji që parashikon një përgjegjësi penale për korporatat, erdhi si fillim i industrializimit dhe shfaqjes së korporatave gjithnjë e më shumë të fuqishme, të afta të kishin një pjesë të madhe të tregut. Kjo gjë që u jepte një fuqi shumë të madhe në ekonominë e vendit. Mendoni rastin e korporatës Ford në fillimin e shekullit të XX-të në SHBA dhe rolin e saj në ekonominë amerikane. Industrializimi dhe shfaqja e korporatave të mëdha në tregun anglofon (SHBA, Kanada, Mbratëria e Bashkuar-MB) është dhe arsyeja pse këto vende janë të parat që kanë ideuar dhe zbatuar ligje të tilla. Herën e parë, kur përgjegjësia penale e korporatave është vënë para ligjit, e gjejmë në vitin 1842 në SHBA. Natyrisht, në këtë epokë dhe deri në ditët tona debati është gjithmonë i hapur. Pas një periudhe vakumi edhe në shtetet skeptikë europian, kjo praktikë filloi të zbatohet. Kjo erdhi si rrjedhojë e një bashkëpunimi gjithnjë e më shumë të zgjeruar ndërkombëtar të korporatave, që solli një përqendrim të fuqisë ekonomike me një dominim të shumëkombësheve. Për një sërë arsyes, këta faktorë strukturorë të shoqëruar me

një rritje të krimit ekonomik sollën domosdoshmërinë për vendet e zhvilluara të vinin gjithnjë e më shumë në lojë përgjegjësinë penale të korporatave. Në këtë pikë doktrina si ajo juridike, ashtu dhe ajo ekonomike duket se janë pak a shumë dakord. Thembra e Akilit është përkufizimi i përgjegjësisë direkte apo jo të korporatës në raport me individin që ka shkelur efektivisht ligjin. E thënë më thjesht, a do të sulmojmë që në fillim korporatën paralelisht me individin shkelës të ligjit, apo do të përdorim atë që specialistët e fushës quajnë "përgjegjësia në kaskadë" (vicarious liability). E rëndësishme në këtë ndarje konceptesh është që në funksion të përgjegjësisë (direkte apo në kaskadë) korporata dhe administratorët e saj duhet të vënë në jetë strategji të ndryshme me kosto dhe burime të ndryshme. Prandaj, në këtë aspekt zbatimi dhe raportet shpjeguese të ideatorëve janë parësore për administratorët e korporatës, përgjegjës të ideimit të politikave strategjike të korporatës.

Në përgjithësi, kushti i nevojshëm që një korporatë të vihet para përgjegjësisë penale është që një vartës i korporatës të ketë thyer ligjin dhe që kjo thyerje ligji të jetë bërë në favor të korporatës. Këto dy kushte duhet të përmbushen në mënyrë solidare me qëllim që përgjegjësia penale e korporatës të vihet para ligjit. Kjo ide është shumë e përhapur në literaturën amerikane dhe ideja mbrapa është që aktiviteti ekonomik në strukturën e sotme të tregut drejtohet nga një numër jo shumë i madh korporatash, dhe si të tilla ato duhet të jenë përgjegjëse për veprimtarinë jo-ligjore që vjen si rezultat i aktivitetit të tyre.

SHBA

Në SHBA përsa i përket zbatimit të ligjit, jurisprudenca, doktrina dhe praktika nisen nga një ndarje e aktivitetit kriminal në 3 grupe: -Grupi i parë përmbledh të gjitha aktet kriminale të rënda e të dënuara penalisht, që kanë lidhje me integritetin fizik të personave si p.sh., cilësia e produkteve të hedhura në treg apo si financimi i terrorizmit. Për këtë grup korporata mund të vihet para ligjit për një akt të kryer nga një vartës i saj nëse

ky i fundit ka vepruar sipas një urdhri direkt të organeve apo personave drejtues të korporatës.

-Grupi i dytë përmbledh aktet e dënuara penalisht, por me një karakter më shumë tregtar sesa atë të integritetit. Për të vënë para përgjegjësisë penale korporatën duhet që dy kushte të plotësohen:

Së pari, vartësi ka kryer aktin në favor të korporatës;

Së dyti, korporata nuk ka treguar përgjegjësinë e duhur për parandalimin e fenomeneve të tilla.

-Grupi i tretë ka të bëjë me aktet e dënueshme penalisht me karakter tregtar, në përmbushjen e të cilave marrëveshja e korporatës është kusht i nevojshëm. Në këtë rast korporata është e dënueshme penalisht, pa pasur nevojë të analizojmë mekanizmat e parandalimit brenda institucionit.

Ideja bazë është që një organizëm me personallitet juridik dhe një farë rëndësie në tregun vendas apo ndërkombëtar duhet të ketë në planet e saj strategjike politika të qarta ndaj luftës kundër krimit dhe jo vetëm kaq. Ajo duhet të parashikojë dhe mekanizma vlerësimi mbi efikasitetin e këtyre politikave për të përballuar efektet e veprimeve kriminale në gjirin e saj. Kjo ndodh sepse numri i madh i individëve që punojnë për korporatën dhe që mund të angazhohen përgjegjësinë penale të saj, bën që elementi kriminal të ndihet anonim. Kjo sjellje e individit kriminal është e njohur tashmë dhe korporata duhet të marrë masa. Pra, nuk ka justifikim. Por këto masa mund të kenë një efekt pervers pasi korporata duke vepruar në një ambient ligjor të tillë nuk ka interes të procedojë direkt elementin kriminal pasi për disa akte kriminale përgjegjësia e saj angazhohet direkt e në paralel me atë të individit. Në këtë aspekt, sistemi i administrimit të rrezikut (risk) dhe funksioni i administratorëve të korporatës është parësor në gjetjen e ekuilibrave në politikat dhe masat parandaluese të korporatës.

AUSTRALI

Në të njëjtin drejtim shkon dhe përvoja australiane përsa i përket përgjegjësisë penale. Procedimi penal i korporatave (personave juridikë) në Australi shikohet si një mjet për të testuar "kulturën tregtare" të korporatës. Me kulturë tregtare nënkuptohet sjellja, politika, rregullat apo praktikat ekzistuese të drejtuara, nxitura dhe të vëna në zbatim nga korporata. Nacioni i kulturës tregtare të ndërmarrjes është shumë i rëndësishëm në strategjinë administruese të korporatave perëndimore pasi kjo informon mbi qëllimet dhe përgjegjësitë që korporata i ka venë vetes.

Pak më ndryshe është konceptimi europian i përgjegjësisë penale të personave juridikë. Por megjithatë duhet thënë që ky konceptim ndryshon nga një vend europian në tjetrin.

FRANCA

Franca, për shembull, përcakton në ligjin e saj në një mënyrë strikte thyerjet e ligjit që mundet të venë para përgjegjësive penale korporatës. Këtu bëjnë pjesë, prezantimi i kontabilitetit fiktiv, dividendët fiktivë, mbivlerësimet spekulative të aktiveve të korporatës, abuzimi me fondet sociale, siguria në punë, përgjegjësia mbi cilësinë dhe përdorshmërinë e produkteve etj. Megjithatë, modeli i preferuar në vënien para ligjit të përgjegjësive penale të personit juridik ngelet ai i përgjegjësive në kaskadë.

GJERMANIA

Më pak pro përgjegjësive penale të personave juridikë është Gjermania. Doktrina gjermane është e mendimit që për personat juridikë përgjegjësia penale është e tepërt dhe që përgjegjësia administrative mjafton në sanksionimin e personave juridikë. Ideja është që korporata nuk ekziston pa organet e saj. Vendimet e organeve reflektojnë vullnetin personal të drejtuesve dhe në këtë mënyrë përgjegjësia penale duhet të drejtohet drejt personave fizikë vendimmarrës në korporatë. Holanda njeh përgjegjësive penale, por në vënien në zbatim të saj ajo fut një nëntitull. Korporata dënohet penalisht edhe për aktet e vartësve të saj, vetëm nëse ajo ka qenë në dijeni për një fakt të tillë.

ZVICRA

Zvicra, nga ana e saj, e ka futur efektivisht në legjislacionin e saj përgjegjësive penale për personat juridikë nga 1 tetori i vitit 2003. Arsyet e këtij ngurrimi janë pak a shumë të njëjta, d.m.th. personi juridik nuk ka një ndërgjegje të tijën, por ajo formohet nga ndërgjegjia përkatëse e drejtuesve të saj. Ajo çka bindi legjislatorin zviceran ishte konstatimi që struktura administruese e korporatave të mëdha po bëhet gjithnjë e më shumë komplekse dhe si e tillë është gjithnjë e më shumë e vështirë të gjejmë "faktorin". Edhe Zvicra përcakton shumë qartë thyerjet e ligjit që venë korporatën direkt para përgjegjësive penale. Mund të përmendim aktivitetin kriminal, financimin e terrorizmit, larjen e parave të pista, korrupsionin. Për këto akte, korporata dënohet pavarësisht nga individit apo drejtuesi saj. Por në përgjithësi, jashtë akteve të sipërpërmendura, ndiqet logjika në kaskadë. Pra, dënohet drejtuesin apo individin që ka kryer veprën penale e vetëm nëse nuk arrihet të identifikohet ky të fundit, i kthehem personit juridik, pra korporatës.

SHQIPËRIA, MES EUROPËS DHE SHBA-SË

Le t'i kthehem tani problematikës sonë. Një konstatim që mundemi të bëjmë nga përvoja e sipërpërmendur, është që megjithëse ekonomitë perëndimore janë në një fazë të përparuar zhvillimi, shumë mëdyshje ekzistojnë në zbatimin e përgjegjësive penale për personat juridikë. Nga projekti i paraqitur, duket

që legjislatori shqiptar ka zgjedhur më shumë përqasjen "e ashpër" dhe direkte të metodës amerikane duke lënë në sfond konceptin e përgjegjësive në kaskadë. Nga një pikëpamje ekonomike kjo ka të bëjë në radhë të parë me strukturën e tregut si dhe me përparimin e asaj që ne quajmë "kulturë tregtare e korporatës". Në një strukturë të koncentruar me shumëkombëshe të fuqishme përgjegjësia penale e personave juridikë gjen konsensus. Në një strukturë të copëzuar tregu konsensual është më i dobët. Në rastin e Shqipërisë mendimi ynë është që jemi më afër një strukture të copëzuar me shumë ndërmarrje individuale me ndikime minimale në politikën ekonomike të vendit. Në refleksionin tonë mund të shkojmë dhe më larg duke pohuar që një faktor me shumë ndikim në anën tjetër mbi ekonominë e vendit janë organizmat shtetërorë. A duhet të parashikojmë një përgjegjësi penale për këto organizma? Në disa vende personat juridikë shtetërorë nuk janë të përjashtuar nga kjo përgjegjësi. Kjo nuk duket të jetë në objektin e këtij ligji.

Së dyti, në vendet praktikuere të këtij koncepti tashmë, problematika e përgjegjësive në përgjithësi është zgjidhur. Përsa i përket përgjegjësive kemi 2 lloj ndarjeje të organizmave: Persona juridikë dhe persona fizikë; Shoqëri personash dhe shoqëri kapitalesh. Kjo ndarje vështirëson pak problemin e përgjegjësive pasi kemi raste si p.sh., shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar ku organizmi është person juridik, por përgjegjësia lidhet direkt me personin që drejton shoqërinë. Në këtë rast, procedimi penal i shoqërisë do të ishte krejtësisht i panevojshëm pasi aktet e kryera nga shoqëria, pavarësisht personalitetit juridik të saj, e gjejnë burimin në vullnetin direkt të pronarit të saj. Duke përdorur këtë logjikë, mendimi dhe të kuptojmë rezervat e doktrinës gjermane ku struktura dominohet nga shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (GmbH) dhe sjelljes zvicerane pro konceptit, pasi struktura ekonomike në Zvicër dominohet nga shoqëri kapitalesh si për shembull, shoqëritë anonime. Në këtë aspekt jemi të mendimit që zbatimi i këtij ligji mund të sjellë çrregullime nga ana e grupeve të interesit. Për të ilustruar këtë pikë, mund të marrim një shembull shumë aktual në dekorin e sotëm të biznesit shqiptar. E theksuam dhe më sipër se nocioni i kulturës tregtare është shumë i rëndësishëm në përcaktimin e përgjegjësive penale të personave juridikë, siç janë korporatat e mëdha. Pyetja që duhet

të drejtojmë është: në skenën shqiptare të biznesit a ka një kulturë të konsoliduar të korporatës dhe totalisht të pavarur nga pronarët apo aksionerët e saj? Sa për qind e ndërmarrjeve shqiptare ekzistojnë dhe veprojnë pavarësisht nga vullneti i pronarëve? A kemi ne në Shqipëri organizma shumë komplekse si p.sh., rasti i gjigantit Nestlé operacionalisht i pavarur nga vullneti i aksionerëve të saj? Ne mendojmë se ky numër është i vogël për të mos thënë zero. I këtij mendimi janë pronarët e sotëm shqiptarë, po i këtij mendimi është mesa duket edhe Qeveria e Shqipërisë. Pa pasur asnjë qëllim politik, natyrshëm mund të shtronim pyetjen: mbi bazën e cilës logjikë organizma shtetërorë kërkojnë kontrolle mbi kompaninë e Dritan Hoxhës dhe jo mbi shoqërinë me personalitet juridik (që do të thotë ekzistencë të pavarur nga personi i pronarit), pra DigitAlb? Kjo tregon edhe një herë që struktura dhe kultura ekonomike në vend nuk ka arritur në fazën e maturisë për të përtypur ligje të tilla. Me këtë afirmim mendojmë që për zbatimin e ligjeve si ky për përgjegjësive penale duhet në radhë të parë një analizë e thellë e strukturave ekonomike dhe sidomos duhet vënë theksi në aftësitë e shtetit në zbatimin e tij. Të bësh si të tjerët, nuk mjafton për të qenë rezultativ, duhet dhe që të jesh si ata me të njëjtat vlera, me të njëjtin integritet e shkallë profesionalizmi. Kjo nuk do të thotë që me këtë logjikë hedhim poshtë përfundimin e këtij ligji. Herët

a vonë biznesi shqiptar do të përballohet me përgjegjësive penale. Për këtë duhet që administratorët të fillojnë punën e tyre duke:

- Pranuar faktin që një ditë korporata e drejtuar nga ata mund të jetë subjekt i përgjegjësive penale;
- Duke organizuar programe për parandalimin e praktikave antiligjore, qofshin ato penale apo administrative;
- Duke kuptuar faktin që individit kriminal vepron në interes të tij dhe jo të organizmit;
- Duke bërë kujdes në politikën nxitëse mbi rezultatet dhe politikën e kompensimit;
- Duke njohur dhe komunikuar sanksionimet e ligjit;
- Duke konceptuar programe dhe departamente përgjegjës për konformitetin ligjor (compliance).

Pra, e thënë ndryshe, duhet pasur si objektiv ndërtimi i një kulture tregtare pakorruptuar që në gjenezë dhe jo konformiteti me ligjet e importuara direkt nga jashtë. ■



OBJEKTIVI

Ndërtimi i një kulture tregtare të pakorruptuar që në gjenezë dhe jo konformiteti me ligjet e importuara direkt nga jashtë.